



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:133112

Datë: 03.07.2023

Numri i dokumentit: 04444532

**PS.nr.26/2022**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**Gjykata Themelore Prishtinë- Departamenti Special** - trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët: Lutfi Shala kryetar, Kujtim Krasniqi dhe Arben Hoti anëtar, me pjesëmarrjen bashkëpunëtores profesionale Luljeta Gashi Metaj, duke vendosur në çështjen penale kundër të akuzuarve **S.K dhe N.A**, për shkak të veprës penale, në bashkëkryerje blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, të rrezikshëm të substancave psikotrope nga neni 267 par.1, lidhur me nenin 31 të KPRK, të akuzuarit **P.C dhe B.C** për shkak të veprës penale, në bashkëkryerje blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, të rrezikshëm të substancave psikotrope nga neni 267 par.1, lidhur me nenin 31 të KPRK, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr.45/2021 të datës 24.06.2022, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik të datës 04.04.2022, ku prezentë ishin, nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës prokurorja Habibe Salhu, i akuzuari S.K dhe mbrojtësi i tij av.B. T., i akuzuari N. A.dhe mbrojtësi i tij av. H. L., i akuzuari P.C dhe mbrojtësi i tij av. G.C., i akuzuari B. C. dhe mbrojtësi i tij av. H. P., gjykata me datë 12.04.2023 mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Të akuzuarit:**

**I.S.K** nga i ati B.t dhe nënës S., i lindur me datë .. në P., me adresë banimi në rr. “S. Q.”, nr. .. në Prizren, i martuar, prind i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ....., i nacionalitetit turk, shtetas i Republikës së Kosovës.

**II. B.A** nga i ati K. dhe nënës B., i lindur me datë .. në P., me adrese banimi në rr. “G.Xh.” nr..., në P., i martuar prind i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. personal 1175833869, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**III.P.C** nga i ati F. dhe nënës V., i lindur me datë .. në P., me adrese banimi në L. G., në P., i martuar, prind i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal 1173675611, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës.

**IV.B.C.**nga i ati F. dhe nënës V., i lindur me datë ... në P., tani me vendbanim në L.G., p.nr., i martuar, baba i një fëmije, student i Elektroteknikës-shkenca kompjuterike, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal .., shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës.

**JANË FAJTOR**

**I.**

**Të akuzuarit:** *S.K dhe N. A.*

**Sepse:** Me datë ... të akuzuarit S.K dhe N. A., pas marrëveshjes paraprake në mes veti, rreth orës 20:40 min janë takuar të ura 'I.' (pompa e vogël e derivateve), përballë Komunë së P.t, në atë mënyre që derisa i akuzuari S.K i është ofruar të akuzuarit N.A me qëllim të shpërndarjes dhe ofrimit për shitje të substancës narkotike të llojit marihuanë duke vepruar në mënyrë të kundërligjshme dhe pa autorizim i akuzuari N. ka blerë substancë narkotike me qëllim të shitjes ku edhe është zanë në flagrancë nga Policia e Kosovës, duke nxjerr nga xhepi të hollat për pagesë të narkotikut, ashtu që i akuzuari S.K pa autorizim dhe me qëllim për shitje ka poseduar substanca narkotike e që pas ekzaminimit ka rezultuar të jetë substancë narkotike e llojit kokainë në peshë të përgjithshme pre  $0.36=0.0001g$ , si dhe në shtëpinë e të njëjtit janë gjetur edhe dy peshore qe shërbejnë për matjen e substancave narkotike, ndërsa i akuzuari B.A pa autorizim dhe me qëllim për shitje ka poseduar tri qese me substancë narkotike të llojit marihuanë ku pas ekzaminimit të substancës narkotike ka rezultuar të kanabis (marihuanë) që përmban tetrahidrokanabinol (THC) në peshë të përgjithshme prej  $1.05=0.0001g$ .

-Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope nga neni 267 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

## II.

**Të akuzuarit:** P.C dhe B. C.

**Sepse.** Pas një hetimi të gjerë nga ana e Policisë së Kosovës me datë .. rreth orës 08:20 në shtëpinë e përbashkët të të akuzuarve P.C dhe B.C gjatë bastisjes së shtëpisë së tyre në rr. "F. H.", L. G., nr., P., është gjetur një peshore elektronike, një qese plastike e tejudkshme e cila përmban supstancë narkotike, tri qese plastike te tejudkshme e mbyllur të cilat përmban subsancë bimore ngjyrë të gjelbër me peshë 4.61 gram, një qese plastike te tejudkshme e mbyllur e cila përmban subsanc bimore ngjyrë të gjelbër me peshë 2.53 gram, një qese plastike te tejudkshme e mbyllur e cila përmban subsanc bimore ngjyrë të gjelbër me peshë 2.07 gram, ku të akuzuarit në bashkëveprim në mënyrë të kundërligjshme dhe pa autorizim kanë poseduar me qëllim të shpërndarjes dhe ofrimit për shitje të substancës narkotike të llojit kanabis (marihunë) që përmban tetrahidrokanabinol (THC) në peshë të përgjithshme prej  $9.21=0.0001g$ .

-Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope nga neni 267 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 7, 8, 9, 10, 17, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, të KPRK-së, si dhe nenit 359, 360, dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të akuzuarve **S.K dhe B.A** për veprën penale si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi i'u shqipton:

### DËNIM ME BURGIM

Ashtu që të akuzuarit **S.K** i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje **4 (katër) vite**, të cilin dënim do ta vuaj 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Ashtu që të akuzuarit **N.A** i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje **3 (tri) vite**, të cilin dënim do ta vuaj 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**Si dhe:**

### DENIMIN ME GJOBË

Ashtu që të akuzuarin **S.K** e gjykon me dënim me gjobë në lartësi prej **5.000 (pesë mijë) euro**, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në gjiro llogarinë e kësaj gjykate në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Ashtu që të akuzuarin **B.A** e gjykon me dënim me gjobë në lartësi prej **2.000 (dy mijë) euro**, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në gjiro llogarinë e kësaj gjykate në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Po që se dënimi me gjobë nuk mund të realizohet konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, të njëjtin gjykata do ta zëvendësoj me dënim me burgim, **duke llogaritur për çdo 20 (njëzet) euro, me 1 (një) ditë burgim.**

Gjykata në bazë të nenit 4, 7, 8, 9, 10, 17, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, të KPRK-së, si dhe nenit 359, 360, dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të akuzuarve, **P.C dhe B.C** për veprën penale si në dispozitivin **II** të këtij aktgjykimi i'u shqipton:

### **DËNIM ME BURGIM**

Ashtu që të akuzuarit **P.C** i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej **2 (dy) vite**, i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Ashtu që të akuzuarit **B.C** i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej **2 (dy) vite**, i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**Si dhe:**

### **DENIMIN ME GJOBË**

Ashtu që të akuzuarin **P.C** e gjykon me dënim me gjobë në lartësi prej **2.500 (dymijë e pesëqind) euro**, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në gjiro llogarinë e kësaj gjykate në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Ashtu që të akuzuarin **B.C** e gjykon me dënim me gjobë në lartësi prej **2.500 (dymijë e pesëqind) euro**, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në gjiro llogarinë e kësaj gjykate në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Po që se dënimi me gjobë nuk mund të realizohet konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, të njëjtin gjykata do ta zëvendësoj me dënim me burgim, **duke llogaritur për çdo 20 (njëzet) euro, me 1 (një) ditë burgim.**

Konform nenit 267 par. 5 të KPRK-së, substancat narkotike llojit kokainë në peshë të përgjithshme prej 036=0.0001g si dhe substancë narkotike të llojit marihuanë, në peshë të përgjithshme prej 1.05=0.0001g, si dhe 3 (tri) peshore konfiskohen.

**OBLIGOHEN** të akuzuarit që secili veç e veç, në emër të shpenzimeve të procedurës penale gjykatës të ia kompensoi shumën prej **100 euro**, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej **100 euro**, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej **100 euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka parashtruar Aktakuzën PPS.nr.45/2021 të datës 24.06.2022, kundër të akuzuarve S.K dhe N.A për shkak të veprës penale, në bashkëkryerje blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, të rrezikshëm të substancave psikotrope nga neni 267 par.1, lidhur me nenin 31 të KPRK, të akuzuarit P.C dhe B.C për shkak të veprës penale, në bashkëkryerje blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, të rrezikshëm të substancave psikotrope nga neni 267 par.1, lidhur me nenin 31 të KPRK.

Gjykata Themlore në Prishtinë-Departamenti Special ka caktuar dhe vazhduar me shqyrtim gjyqësor ndaj të akuzuarve S.K., N.A.,P.C dhe B.C gjatë shqyrtimit gjyqësor të akuzuarve në bazë të nenit 319 të KPRK-së, janë udhëzuar me të drejtat e tyre ligjore dhe pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorisë

Speciale të Republikës së Kosovës, të njëjtit janë udhëzuar në bazë të nenit 322 par.1 të KPPRK-së, mbi të drejtat për deklarimin e pranimit apo mos pranimit të fajësisë, në këtë drejtim të akuzuarit janë njoftuar nga gjykata për pasojat që rezultojnë nga pranimi i fajësisë dhe kushtet e përcaktuara me nenin 242 par.1 dhe par.2 pika 2.1 deri 2.4 të KPPRK-së, që pranimi nga ana e tyre të konsiderohet i vlefshëm.

**I akuzuari S.K** në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se nuk e ndien vetën fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet.

**I akuzuari N.A** në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se e ndjen vetën fajtor për veprën penale blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, të rrezikshëm të substancave psikotrope nga neni 267 par.1, lidhur me nenin 31 të KPRK.

**I akuzuari P.C** në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se e ndjen vetën fajtor për posedim të narkotikut por nuk e ndjen vetën fajtor për veprën penale për të cilën e ngarkon akuza e PSRK-se.

**I akuzuari B.C** në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se nuk e ndien vetën fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet.

Trupi gjykues pas deklarimeve lidhur për fajësinë nga të akuzuarit dhe mendimeve mbrojtësve të tyre dhe mendimin e Prokurorit të Prokurorisë Speciale, me aktvendim refuzoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit **B.A** se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope nga neni 267 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, pasi që ky pranim është i pjesshëm dhe nuk është ne përputhshmëri me dispozitat ligjore, si dhe i njëjti pranim bie në kundërshtim edhe me deklarimin e mbrojtësit të tij i cili deklaroi se klienti i tij nuk e ka të qartë dhe se i njëjti pranon fajësinë vetëm për posedimin e narkotikut por jo edhe për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza andaj gjykata ka vazhduar me fjalën hyrëse, dhe janë administruar provat personale dhe materiale.

**Prokurorja e Prokurorisë Speciale e Republikës së Kosovës Habibe Salhu**, gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 0..4.04.2023, si dhe në fjalën përfundimtare të parashtruar me shkrim e të elaboruar edhe në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se, bazuar në provat e siguruar paraprakisht e të cilat janë administruar gjatë, konsideroj, se pa mëdyshje u vërtetua dyshimi i bazuar mirë, se në veprimet e te pandehurve, janë manifestuar elementet e veprës penale për të cilën të njëjtit ngarkohen. Në veprimet e të pandehurve janë manifestuar elementet e veprave penale u vërtetua nga provat që u administruan ne shqyrtim gjyqësore dhe atë: nga dëshmia e dëshmitarit B.B të dhëne në shqyrtim gjyqësor me dt..., pa mëdyshje u vërtetua se i njëjti është përdorues i substancave narkotike dhe për dy vite radhazi është furnizuar me narkotike vetëm tek i akuzuari N.A. Pra, nga dëshmia e këtij dëshmitari u vërtetua se i njëjti me qëllim të shitjes ka poseduar narkotike edhe ne ditë kritike. Po ashtu u vërtetua se B.A merret me substanca narkotike edhe nga dy dëshmitaret e tjerë si nga dëshmitari V.M po ashtu edhe nga dëshmitari R.R të cilët vërtetuan një gjendje te tillë. Me tej Prokurorja e Prokurorisë Speciale ka theksuar se gjendja faktike në këtë çështje penalo - juridike, u vërtetuar edhe nga provat materiale të administruar në shqyrtim gjyqësor. Nga raporti nga vendi i ngjarjes - tek ura "I." (pompa e vogël e derivateve), përball komunës së P., ...i datës .., u vërtetuar se në ditën kritike të akuzuarit S.K dhe N.A, janë zënë duke shkëmbyer substanca narkotike si dhe duke u bërë pagesa për të njëjtat. Po ashtu një gjendje e tillë faktike u vërtetua edhe nga fotoalbumi nga vendi i ngjarjes ... tek ura "I." (pompa e vogël e derivateve), përball komunës së P. me çka ka u vërtetuar se në ditën kritike të pandehurit janë zënë në flagrancë dhe kjo vërtetohet nga fotot e vendit të ngjarjes. Po ashtu , nga vërtetim për sekuestrim të përkohshëm të sendeve në vendin e ngjarjes, nr. ... u vërtetua se i akuzuari S.K ditën kritike ka poseduar shumë prej 190€ e që janë mjete materiale të përfituara me kryerjen e veprës penale. Nga raporti nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë mbi ekzaminimin e substancave narkotike të gjetura në vendin e ngjarjes - tek ura "I." (pompa e vogël e derivateve), përball komunës së P. data e përfundimit .., u vërtetua se substancat narkotike të cilat në ditën kritike i ka poseduar i akuzuari S.K e të cilat në momentin që ishte duduë ia dorëzuar të akuzuarit N., derisa i njëjti ishte duke ia bërë pagesën për këtë lloj të substancës narkotike, janë substanca të llojit kanabis (marihuanë) që përmban tetrahidrokanabinol (THC) në peshë të përgjithshme prej  $1.05=0.0001g$  si dhe substancë narkotike e llojit kokainë në peshë të përgjithshme prej  $036=0.0001g$ . Po ashtu nga ky

raport vërtetohet se qesja e cila është gjetur në shtëpinë e të akuzuarit S.K kishte përmbajtje të kokainës me çka vërtetohet shumë qartë se i akuzuari merret me posedim të substancave narkotike me qëllim të shitjes, e kjo më së miri vërtetohet edhe nga peshorja e cila në ditën kritike është gjetur në shtëpinë e të akuzuarit S. K.. Nga raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes - në shtëpinë e të akuzuarve Petrit dhe B.C-dosja eforenzikës ... datë .. , u vërteta se në shtëpinë e tyre kanë poseduar 3 qese me substancë narkotike të llojit marihuanë. Po ashtu një gjendje e tillë faktike u vërtetua edhe nga fotoalbumi nga vendi i ngjarjes - në shtëpinë e të akuzuarve P. dhe B.C- .... nga i cili rezulton se janë gjetur 3 qese me substanca narkotike. Nga Raporti nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë mbi ekzaminimin e substancave narkotike të gjetura në shtëpinë e të akuzuarve P. dhe B.C data e përfundimit .. u vërtetua se janë tri qese me substancë narkotike, ku pas ekzaminimit ka rezultuar të jetë kanabis (marihuanë) që përmban tetrahidrokanabinol (THC) në peshë të përgjithshme prej 9.21=0.0001g. Se në veprimet e të akuzuarit S.K manifestohen elementet e veprës penale siç është përshkruar si në pikën e parë të aktakuzës vërtetohet edhe nga Raportet e Policisë, gjegjësisht nga raportet për zbatimin e masave të fshehta ashtu që nga Raporti i datës 04.04.2021 vërtetohet se i akuzuari S.K bashkëvepron edhe me persona të tjerë të cilët dyshohet se merren me vepra penale që ndërlidhen me narkotikë. Një gjendje e tillë vërtetohet nga bisedat që janë zhvilluar në mes të akuzuarit S.K dhe personave të tjerë e që kjo vërtetohet nga raporti i datës 19.04.2021. Tutje prokurorja e PSRK ka theksuar se i akuzuarit P.C merret me narkotik të llojeve të ndryshme vërtetohet edhe nga bisedat që i njëjti i kishte zhvilluar me personat e tjerë e që kjo më së miri vërtetohet nga transkriptet që i janë bashkëngjitur Raportit informues të datës ... Nga ky raport vërtetohet shumë qartë se nuk qëndron deklarata e të akuzuarit P.C se i njëjti asnjëherë nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim që ndërlidhet me veprën penale të lartcekur dhe se pranimit i fajësisë gjëja për shkak të gjendjes shëndetësore të vëllait të tij, është vetëm qëllim i tij gjëja se bartë përgjegjësinë e vëllait i cili është në gjendje të rëndë shëndetësore. Po ashtu, se në veprimet e të akuzuarit B.C manifestohen elementet e veprës penale siç është përshkruar si në pikën e dytë të kësaj Aktakuze vërtetohet edhe nga deklaratat e këtyre të akuzuarve të dhënë në Polici dhe në Prokurori, por edhe në provat tjera që janë bashkëngjitur kësaj Aktakuze, vërtetohet se dy të akuzuarit P.C edhe B.C janë konsumues të substancave narkotike dhe se substancat narkotike që në ditën kritike është gjetur në shtëpinë e tyre ka qenë substancë narkotike që të njëjtit kanë përdor personalisht dhe kane shitur edhe tek personat e tjerë.

Po ashtu propozoj që mjetet materiale të konfiskura nga S.K K., sipas Urdhëresës e Gjyqtarit të Procedurës Paraprake PPPSnr.19/2021, të datës 28.09.2021, janë mjete materiale që janë përfituar me aktivitet kriminal, konform nenit 284 par. 1 dhe 3 të KPPK-së, propozojmë që të konfiskohet dobia pasurore të cilën i akuzuari i ka realizuar si rezultat i veprave penale të kryera. Prokurorja e PSRK si përfundim ka theksuar se duke i çmuar këto prova në lidhshmëri logjike dhe faktike me njëra tjetrën, do të vërtetohet se në veprimet e të akuzuarve qëndrojnë të gjitha elementet e veprave penale të përshkruar si në dispozitivët e kësaj aktakuze. E njëjta I ka propozuar gjykatës që të akuzuarit të shpallen fajtorë për këto vepra penale, duke marrë parasysh edhe rrethanat tjera që ndikojnë në lartësinë e dënimit . Po ashtu duke marrë parasysh dhe faktin se të akuzuarit edhe me parë kanë renë ndesh me ligjin, për vepra penale të natyrës së njëjtë, kanë qenë disa herë edhe në burg për vepra të tilla , por sipas Raportit të Policisë të dt. 01.02.2022 me nr. reference ... edhe tani i njëjfi gjendet në paraburgim për vepër të natyrës së njëjtë po ashtu edhe te pandehurit tjerë, edhe me pare kane kryer vepra penale te natyrës se njëjte

**Mbrojtësi i të akuzuarit S.K av. B. T.,** gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 04.04.2023, si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, e kundërshtonë në tersi arsyetimin e PSRK-se, dhe konsiderojmë që pas analizimit konstatimit dhe sintetizimit të tërësishëm të pretendimeve PSRK , mbrojtjes dhe të provave të administruar , logjikshëm , rrjedhshëm e përtej çdo dyshimi është vërtetuar e pa bazuar aktakuza. Sa i përket qeses se najlonit që është gjetur në shtëpinë e të pandehurit përveç se pluhuri që ka rezultuar lende narkotike në një sasi të vogël e që i pandehuri nuk e ka kontestuar që është apo nuk është lende narkotike dhe nga aspekti që është kryefamiljar sipas traditës është deklaruar se çdo gjë që mund të gjendet brenda territorit që e ka në kontroll , formal edhe pse kontrolli faktik donë kushte tjera, në e kundërshtojmë akuzën , nuk e pranon përgjegjësin sepse kryefamiljari nuk bart përgjegjësi penale, ngjashëm me përgjegjësin objektive, ndërsa lidhur me akuzën për shitje të lendes narkotike si qeshte përshkruar në dispozitiv dhe fjalë përfundimtare e kundërshtojmë të pa bazuar sepse nuk vërtetohet me asnjë prove , e vetmja prove që nuk prodhon efekt juridik është deklarata e bashke të pandehurit e dhënë në polici, andaj po të ishte deklaruar i pandehuri para gjykatës dhe t'kishin mundësi që ta intervistonin do të vërtetohej

fakti qe deklarata e tij ka qen ne afekt dhe me qellim te shmangies se vetvetes nga përgjegjësia penale. Andaj pasi qe konfrom dispozitave te Kodit te Procedurës Penale i pandehuri nuk shpallet fajtor vetëm me një prove dhe nuk mund te shpallet fajtor me deklaratën e te bashkëpandehurit ne te njëjtën procedure, ndërsa provat tjera nuk e vërtetojnë veprën dhe përgjegjësia penale, andaj veprimet e te pandehurit ashtu qysh i kemi theksuar edhe ne fazat e me hershme as individualisht e as ne tërësi nuk përbejnë figurën e veprës për te cilën është akuzuar e as për ndonjë vepër tjetër penale. Mbrojtësi i të akuzuarit S.Kav Bahtir Troshupa i ka propozuar që ndaj të mbrojturit të tij, gjykata te nxjerr aktgjykim lirues.

**I akuzuari S.K në fjalën përfundimtare ka deklaruar, se e mbështet në tërësi deklarinimin e mbrojtësit të tij.**

**Mbrojtësi i të akuzuarit N.A av.H. L.,** gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe në fjalën përfundimtare të parashtruar me shkrim e të elaboruar edhe në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar, se i mbrojturi im ka N.A e ka pranuar fajësinë, është përdorues i marihuanës të cilën e ka blerë të S. K.. Tani e ka ndërpre nuk e përdor nuk e konsumon ma marihuanen, për çka e ka pi se bashku me dëshmitaret B.B., V. M. dhe R. R.. Tutje ka theksuar se nuk është e vërtet se dëshmitarëve ua ka shitur narkotikun-marihuanën kur ka blerë për vete ka blerë edhe për B.B sipas kërkesës së tij. Po ashtu nuk është e vërtete se narkotikun ia ka shitur V. M. e R.R., të cilët edhe në gjykatë deklaruan se nuk kanë blerë narkotik nga N.A, pasi qe N. A. e ka gjendjen e rëndë ekonomike e sociale, i njëjti banon me qira, bashkëshorten ka studente dhe ka dy fëmijë të mitur, njërin fëmijë e ka të sëmur me aftësi të kufizuara të përhershme. Provë- Aktvendimi i KK-Prizren.

Mbrojtësi i të akuzuarit N.A av.H. L. i ka propozuar gjykatës qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese e ti shqiptoj një dënim sa me të but, si dënim me kusht.

**I akuzuari N.A, në fjalën përfundimtare ka deklaruar, se e mbështet në tërësi deklarinimin e mbrojtësit të tij.**

**Mbrojtësi i të akuzuarit P.Cav.G.C** gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe në fjalën përfundimtare të parashtruar me shkrim e të elaboruar edhe në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar, se pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, në të cilin u dëgjuan dëshmitarët e propozuar nga Prokuroria, si dhe pas administrimit edhe provat materiale të bashkëngjitura Aktakuzës dhe vlerësoj se me asnjë nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk është provuar përtej dyshimit të bazuar se i mbrojturi im e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Në veprimet e tij nuk manifestohen asnjëri nga elementet qenësore që përbëjnë figurën e veprës penale për të cilën akuzohet, sepse nga gjendja e vërtetuar e fakteve nuk del se ekzistojnë prova të cilat tregojnë se P.C e ka kryer veprën penale të përshkruar në dispozitiv të Aktakuzës. Nga gjendja e provave nuk del se ai kishte ndërmarr çfarëdo veprimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me qëllim të kryerjes së veprës penale me të cilën akuzohet. Me tej ka theksuar se gjykatës i vë në pah disa fakte të rëndësishme të cilat duhet t'i ketë parasysh me rastin e marrjes së vendimit për fajësinë apo pafajësinë e P.C Po ashtu bazuar ne nenin (256) 119, par. 2 i KPPRK-së: Provat e siguruara gjatë marrjes në pyetje në procedurë paraprake mund të përdoren si bazë për të forcuar urdhrat hetues në procedurë paraprake, vendimet për paraburgim dhe aktakuzën. Provat e siguruara gjatë marrjes në pyetje në procedurë paraprake nuk mund të përdoren si provë e drejtpërdrejtë gjatë shqyrtimit kryesor, por mund të përdoren gjatë marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje, marrjes së tërthortë në pyetje dhe rimarrjes në pyetje, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë Kod. Po ashtu Prezumimi i Pafajësisë dhe Barra e të Provuarit, janë të artikuluara në të gjitha konventat kryesore ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut dhe janë të mishëruara edhe në nenin 3 të KPPRK-së (Prezumimi i pafajësisë i të pandehurit dhe in dubio pro reo) dhe në nenin 7, par. 1 të KPPRK-së (Detyrimi i përgjithshëm për vërtetimin e plote dhe te sakte te fakteve). Tutje ka shtuar se gjatë shqyrtimit gjyqësor u vërtetua se Prokuroria, gjatë hetimit e po ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, provat i ka vlerësuar në mënyrë të njëanshme dhe selektive duke i marrë për bazë dhe duke i vlerësuar vetëm ato prova dhe fakte të cilat ka besuar se shkojnë në favor të Aktakuzës, e jo edhe provat dhe faktet që shkojnë në favor të mbrojtjes. Po ashtu mbrojtja vlerëson se Aktakuza e Prokurorisë është ndërtuar në kundërshtim me nenin 235 par 1.7 të KPPRK-së, sepse Prokuroria në dispozitiv të Aktakuzës nuk ka dhënë shpjegimet e mjaftueshme të arsyeve për ngritjen e Aktakuzës. Si dhe kjo nuk është bërë edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor sepse aktakuzës i mungojnë

referenca të qarta të provave në lidhje me faktet vendimtare. Nga te cekurat me lart prokuroria nuk ka dhënë asnjë vlerësim, e po ashtu edhe një arsye të vetme se më cilat prova ka vërtetuar se P.C ka kryer veprën penale të përshkruar në dispozitiv të Aktakuzës. Po ashtu, në arsyetimin e Aktakuzës, Prokuroria nuk ka dhënë asnjë vlerësim të vetin lidhur me saktësinë e provave dhe lidhjen kauzale në mes tyre dhe veprimeve të të pandehurit. Prandaj arsyetimi i aktakuzës dominohet me shpjegime nga rast tjetër i cili nuk ka të bëjë fare me rastin në fjalë dhe për të cilin janë pushuar hetimet, pastaj në arsyetim janë të përfshira deklaratat e dëshmitarëve dhe të akuzuarve, por që kërkohet nga ligji që prokuroria t'i shpjegoj përmes analizës se cilat janë arsyet për ngritjen e aktakuzës, mungojnë dhe nuk janë ofruar nga prokuroria. Për këtë arsye aktakuza nuk e plotëson kushtin nga neni 235 par. 1.7 i të KPPRK-së. Nga ana tjetër prokuroria e ngarkon P.C që në bashkëveprim me vëllain e tij B.C kanë kryer veprën penale blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope nga neni 267 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. I njëjti ka theksuar se figura e kësaj vepre penale përbëhet nga disa elemente esenciale. Elementi i parë i kësaj vepre penale është *blerja e narkotikëve*, substancave psikotrope a substancave analoge të rrezikshëm me qëllim të shitjes, shpërndarjes ose ofrimit për shitje, ndërsa elementi i dytë i kësaj vepre penale është *posedimi i narkotikëve*, substancave psikotrope vetëm për qëllim të shitjes, shpërndarjes a ofrimit për shitje. Pra vepra penale për të cilën ngarkohet i pandehuri ekziston vetëm nëse narkotikët, substancat psikotrope a preparatet e shpallura të rrezikshme blihen ose posedohet vetëm për shitje, shpërndarje a ofrim për shitje. Ndryshe nëse i pandehuri blen ose posedon narkotikë, substanca psikotrope a preparate të shpallura të rrezikshme, për qëllim të shitjes, shpërndarjes a ofrimit për shitje, atëherë nuk do të ekzistoj kjo vepër penale. Andaj i mbrojturi im, në të gjitha deklaratat e tij në të gjitha fazat e procedurës, nuk e ka mohuar faktin e posedimit të substancës narkotike dhe atë për nevojat të vëllait të tij, pasi që ai edhe për shkak të problemeve psikike, është konsumues i substancave të tilla dhe është në terapi të shërimit dhe pastrimit. Me tej ka shtuar se prokuroria e ka obligim ligjor që me prova materiale, e personale, të vërtetoj përtej dyshimit të bazuar mirë se i mbrojturi im ka kryer veprimin e blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe të substancave psikotrope. D.m.th. nëse i mbrojturi im është shitësi, atëherë për ne dhe gjykatën duhet ditur *kush është blerësi*. Nëse i mbrojturi im është shpërndarësi, atëherë *duhet dituri destinacioni*, vendi i shpërndarjes, porositi apo edhe pranuesi i mallit etj. Nëse i mbrojturi im e ka poseduar për qëllime të *shitjes apo shpërndarjes*, atëherë duhet të identifikohet blerësi i mundshëm, apo rrugët e shpërndarjes. Të gjitha këto veprime duhet të provohen përtej dyshimit të bazuar mirë me prova materiale, dëshmitarë etj, e jo të mbetet vetëm në nivelin e dyshimit dhe spekulimit. Pra nga provat materiale dhe personale të administruara në shqyrtim gjyqësor nuk është vërtetuar në asnjë rast këto elemente në mënyrë që të ndërtohej figura e veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri P. C. Duke marr parasysh se prokuroria ka propozuar që të dëgjohen në cilësinë e dëshmitarit, dëshmitarët B. B.V.M dhe R. R.. Që të tre këta dëshmitar janë dëgjuar në seancën e shqyrtimit kryesor dhe ne pyetjen e mbrojtjes se a e njihni të pandehurin P.C që të tre pa asnjë hezitim, janë shprehur se nuk e njohim. Dëshmitarët janë ftuar nga prokuroria me qëllim të vërtetimit të elementit të shitjes së substancave narkotike pasi që të njëjtit edhe ishin konsumues të tyre. Andaj nga dëshmia e dëshmitareve të lart përmendur i vetmi fakt që është *provuar apo vërtetuar* është se dëshmitarët kanë konsumuar substanca narkotike, ose edhe e kanë blerë atë nga i pandehuri i dytë N.A, por në asnjë rast nga i pandehuri P. C.. Si përfundim i njëjti ka theksuar se Prokuroria e Shtetit pa dhënë shpjegimin e mjaftueshëm të arsyeve për ngritjen e aktakuzës, pa referenca të qarta në provat që vërtetojnë faktet kryesore, pa e vlerësuar besueshmërinë ose jo të provave, gabimisht, në mënyrë selektive dhe të njëanshme, i ka marr si të mirëqena vetëm ato prova të cilat shkojnë në favor të aktakuzës, por jo edhe deklaratat dhe mbrojtjen e të pandehurit e cila në tersi është në favor të mbrojtjes. Mbrojtësi i të akuzuarit P.C av.G. C. ka shtuar se prokuroria nuk ka arritur ta vërtetoj përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri është fajtor për veprën për të cilën akuzohet, andaj mbi këtë bazë, i ka propozuar gjykatës që në pajtim me nenin 363 të KPPRK-së, të mbrojturin e tij P.C ta LIROI nga akuza sepse nuk është provuar përtej dyshimit të bazuar mirë se e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

**I akuzuari P.C në fjalën përfundimtare ka deklaruar**, se e mbështet në tërësi deklarimin e mbrojtësit të tij.

**Mbrojtësi i të akuzuarit B.Cav. H. P.**, gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar, nëse i referohemi aktakuzës respektivisht dispozitivit të aktakuzës e njëjta është e mangët dhe

e njëjta nuk është përpiluar në pajtim me nenin 241 par. 1 pika 1.4 meqenëse nuk janë përshkruar të gjitha rrethanat faktike që përcaktojnë me saktësi veprën penale që e ka krye i mbrojturi im B.C. Me tej ka theksuar se në këtë çështje juridiko penale mungon dyshimi i bazuar mirë si kusht esencial për ngritjen e aktakuzës, andaj në këtë aktakuzë mungojnë prova relevante dhe të pranueshme që të bind gjykatën që një vepër penale ka ndodhur dhe që është kryer nga I mbrojturi im B.C Po ashtu në se i referohemi veprës penale në pikën II të dispozitivit të aktakuzës, është relevante të ceket se substancat narkotike tri qese të najlonit të llojit marihuanë janë gjet në shtëpinë e P.C dhe B.C po ku jeton edhe vëllai tjetër i tyre T. C. por dhe babai i tyre Fatmiri dhe nëna e tyre, pra nga ky fakt parashtrohet pyetja si vijon: Nëse i referohemi Kapitullit II të Kodit Penal -Veprat penale dhe përgjegjësia penale dhe atë nenit 17 të Kodit penal është përgjegjësi individuale. Tutje ka theksuar Bazuar në dispozitën e lartshënuar si dhe nëse i referohemi deklaramit të bashkakuazarit P.C vëllait të akuzuarit B. në seancën fillestare me datë . i cili e ka pranuar se të tria qese e substancës narkotike të llojit marihuanë e që janë gjet në shtëpinë e përbashkët në Prizren ku jeton edhe i mbrojturi im B. janë të tijat të P. C., andaj ky fakt e përjashton përgjegjësinë penale të mbrojturit tim për të cilën është akuzuar. Andaj vlen të potencohet fakti se Prokuroria Specialë pa bazë e akuzon të mbrojturin tim për veprën të cekur në pikën II të dispozitivit të aktakuzës dhe bie ndesh me . nenin 17 të Kodit Penal, meqë me dispozita pozitive në Republikën e Kosovës, përgjegjësia penale është individuale e jo kolektive, andaj po të zbatohet kjo logjikë atëherë si bashkëkryes në kryerjen e kësaj vepre penale duhet të përfshihen të gjithë personat që jetojnë në atë shtëpi, mirëpo pranimi i posedimit nga ana e të akuzuarit Petrit në gjykatë e përjashton të mbrojturin tim, pasi qe nuk ka asnjë provë të kapshme se ky ka marrë pjesë në kryerjen e kësaj vepre penale. Mbrojtësi i të akuzuarit B.C av. H. P. bazuar në të dhënat e cekura si gjatë procedimit të kësaj çështje penale nga ana e gjykatës pa mëdyshje u vërtetua se i mbrojturi im është i pafajshëm, i ka propozuar gjykatës që konform nenit 363 par.1 nën par.1.3 të KPPRK-së, të merr aktgjykim lirues meqë nuk është provuar se i mbrojturi i tij B.C e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

**I akuzuari B.C në fjalën përfundimtare ka deklaruar, se e mbështet në tërësi deklaramin e mbrojtësit të tij.**

Në shqyrtimin gjyqësor publik gjykata konform nenit 7 të KPPK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plot vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrje të vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimale profesional dhe përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarve, si dhe ato në favor të tyre, duke i mundësuar të akuzuarve shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerrë përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

Pas procedimit të provave personale dhe materiale në shqyrtimin gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht me njëra-tjetrën, në kuptim të nenit 360 par.1 dhe 2 të KPPK-së, kjo gjykatë ka vërtetuar se ka prova se të akuzuarit S.K dhe N.A.në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope nga neni 267 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi, ndërsa të akuzuarit P.C dhe B.C në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope nga neni 267 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së si në dispozitivin II të këtij aktgjykimi.

***Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor me administrimin e provave personale si:*** dëgjimi i dëshmitarit B.B të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të dt. 01.03.2023, dëgjimin e dëshmitarit R.R. të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të dt. ..., dëgjimin e dëshmitarit V.M të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të dt..., ***Si dhe me provat materiale të administruara në shqyrtimin gjyqësor siç janë :*** Raporti i vendit të ngjarjes tek ura ‘‘I.’’ ( pompa e vogël e derivateve) përballe komunës së P.2020-DHTN i datës ....Fotoalbumi nga vendi i ngjarjes tek ura ‘‘I.’’ ( pompa e vogël e derivateve) përballe komunës së P.. Vërtetimi për sekuestrim të përkohshëm të sendeve në vendin e ngjarjes, nr.... i datës ..., Raporti nga Agjencia e Kosovës për forenzik mbi ekzaminimin e substancave narkotike të gjetura në vendin e ngjarjes tek ura ‘‘I.’’ ( pompa e vogël e derivateve) përballe komunës së P. datë e përfundimit ..., Fotoalbumi nga vendi i ngjarjes- në shtëpinë e të akuzuarve P. dhe B.C i datës ..., Vërtetimi për sekuestrim



të përkohshëm të sendeve në shtëpinë e të akuzuarve P. dhe B.C Raporti nga Agjencia e Kosovës për Forenzik mbi ekzaminimin e substancave narkotike të gjetura në shtëpinë e të akuzuarve P. dhe B.C me datë përfundimi ..., Raporti informues me transkript të akuzuarit P.C me nr ..., si dhe shkresat e tjera të cilat janë pjesë e shkresave të lëndës.

***Të gjitha këto prova gjykata i ka vlerësuar si prova të pranueshme dhe se i ka administruar si të tilla.***

**Provat personale-dëshmitari B.B** në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës ... ka deklaruar, se njihet vetëm me N.A me të cilin shoqërohet rrallë, dhe se nga i njëjti ka marrë marihuane për përdorim personal pasi që ka qenë përdorues diku rreth dy vite, ndërsa ka njohuri se përdorues i substancave narkotike është edhe N. për të tjetër nuk di, dhe se prej të njëjtit jam furnizuar, nga askush tjetër s'jam furnizuar. Me tej ka shtuar se prej N. një cigare e ka marr për shumën 5 euro, dhe atë rrallë ndonjë herë diku një në dy tri ditë, ndërsa se ku e ka marrë N. nuk di, por me të njëjtin kemi pi bashkë edhe kam marr prej tij dhe kam blerë prej tij po ashtu e kam porositur se kur te blen për vete te merr edhe për mua me çmimin e njëjtë e për çka është dashtë edhe unë me ia dhanë paret N., ndërsa të akuzuarin S. K. i njëjti është përgjigjur se nuk e njeh.

**Dëshmitari V.M** në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës ... ka deklaruar, se nuk është përdorues i substancave narkotikeve por ka konsumuar ndonjë herë me shoqëri dhe atë shumë rrallë kur është takuar me shoqëri në kafiterin dhe kur jemi taku me shoqëri ndonjëherë e kemi konsumuar te gjithë se bashku. Substancat narkotike i ka pasur dikush prej shoqërisë e këna dhez krejt e këna përdor, se bashku me N. dhe këtu në sall është i vetmi qe njoh. Me tej i njëjti ka theksuar se nuk ka marr kurrë substanca narkotike prej N., përveç se me N. bashke e kemi konsumuar ne ndonjë rast, se N. e konsumon e din familja e vet. Tutje shton se ka biseduar në telefon me N. dhe se ka mundur që të me ketë thënë a donë diçka pasi që i njëjti ka punuar kasap, ka mundur të me pyet a don mish, por jo për narkotik. Po ashtu theksoj se nuk di prej kujt është furnizuar dhe nuk e kam pyet kurrë se nuk me ka interesua, nërsa të akuzuarit S.K dhe P.Ci njëjtit është përgjigjur se nuk i njeh.

**Dëshmitari R.R** në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës .. ka deklaruar se nga të akuzuarit të cilët gjenden në sall e njef N.A se kam punuar bashkë me të në mishtore si dhe e njof S.K me S. s'kam kurrfarë raporti ndërsa me N. kemi punuar bashke edhe kur takohem rrallë najë here përshëndetem, i kem raportet mire skemë të këqija. Po ashtu ka shtuar se nuk është furnizuar me narkotik nga te akuzuarit përveç se me përdor po dhe atë me N. kemi pi bashke marihuane gjatë kohës qe kemi punuar, ndërsa nuk jemi furnizuar nga një person i caktuar kah kemi mujt jemi furnizuar. Prokurorja e çështjes me leje të Trupit Gjykues ia rikujtoj një deklaratë të dëshmitarit të dhënë ne polici "me dt.27.10.2021 ne faqen e dytë të kësaj deklaratë ne pyetjen e policit se a je shkuar ndonjëherë me N. bashke të S., përgjigja juaj ka qenë, pas punës N.me merr shpesh ndërsa rrallë jemi takuar bashke të M. M. me S. dhe kemi pire kafe, a është e vërtet kjo që ke deklarua ne polici". I njëjti është përgjigj po e vërtet se at ditë jemi takuar rastësisht dhe kafen e kam pi me N. dhe me S. jo. Po ashtu i njëjti ka shtuar se me N. njihen qe 3 apo 4 vite, dhe kur kem filluar me punu i kam treguar se unë jam përdorues edhe ai me ka treguar se është përdorues dhe e kemi përdor bashke. Tutje thekson se mua s'me ka shit substanca narkotike as N.e askush tjetër që është ne salle mirëpo me përdor e kam përdor.

**I akuzuari S. K. në mbrojtjen e tij** të dhënë në shqyrtim gjyqësor të dt... ka deklaruar se, i ka kuptuar te drejtat dhe detyrimet qe ia ka lexuar gjykata, ka theksuar se për këtë çështje penale do ta shfrytëzoj të drejtën time të mbrohem në heshtje.

**I akuzuari N.A në mbrojtjen e tij** të dhënë në shqyrtim gjyqësor të dt...ka deklaruar se, i ka kuptuar te drejtat dhe detyrimet qe ia ka lexuar gjykata, po ashtu ka theksuar atë çka e kam bërë e kam deklaruar edhe me parë se jam përdorues i marihuanës si dhe ka shfrytëzuar të drejtën e tij të mbrohet në heshtje.

**I akuzuari P.C në mbrojtjen e tij** të dhënë në shqyrtim gjyqësor të dt... ka deklaruar se, i ka kuptuar te drejtat dhe detyrimet qe ia ka lexuar gjykata, po ashtu ka mbështet deklaratimet në procedura të mëhershme dhe ka theksuar se dëshiron të shfrytëzoj të drejtën e tij të mbrohet në heshtje.

I akuzuari **B.C në mbrojtjen e tij** të dhënë në shqyrtim gjyqësor të dt... ka deklaruar se, i ka kuptuar te drejtat dhe detyrimet qe ia ka lexuar gjykata, dhe ka theksuar se dëshiron të shfrytëzoj të drejtën e tij të mbrohet në heshtje.

## I.

Pas procedimit të provave personale dhe materiale në shqyrtimin gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht me njëra-tjetrën, në kuptim të nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPK-së, kjo gjykatë ka vërtetuar se ka prova se të akuzuarit **S.K dhe N.A** në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope nga neni 267 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor ka vërtetuar se të akuzuari S.K dhe N.A me datë 23.09.2021 të akuzuarit S.K dhe N.A pas marrëveshjes paraprake në mes veti, rreth orës 20:40 min janë takuar të ura ‘‘I.’’ ( pompa e vogël e derivateve), përballë Komunë së Prizrenit, në atë mënyre që derisa i akuzuari S.K i është ofruar të akuzuarit N.A me qëllim të shpërndarjes dhe ofrimit për shitje të substancës narkotike të llojit marihuanë duke vepruar në mënyrë të kundërligjshme dhe pa autorizim i akuzuari N. ka blerë substancë narkotike me qëllim të shitjes ku edhe është zanë në flagrancë nga Policia e Kosovës, duke nxjerr nga xhepi të hollat për pagesë të narkotikut, ashtu që i akuzuari S.K pa autorizim dhe me qëllim për shitje ka poseduar substanca narkotike e që pas ekzaminimit ka rezultuar të jetë substancë narkotike e llojit kokainë në peshë të përgjithshme pre 0.36=0.0001g, si dhe në shtëpinë e të njëjtit janë gjetur edhe dy peshore qe shërbejnë për matjen e substancave narkotike, ndërsa i akuzuari B.A pa autorizim dhe me qëllim për shitje ka poseduar tri qese me substancë narkotike të llojit marihuanë ku pas ekzaminimit të substancës narkotike ka rezultuar të kanabis (marihuanë) që përmban tetrahidrokanabinol (THC) në peshë të përgjithshme prej 1.05=0.0001g.

Këtë gjendje faktike gjykata e vërtetoi nga provat personale të administruara në shqyrtimi gjyqësor siç është dëshmia e dëshmitarit **R.R** të dhënë në shqyrtim gjyqësor të datës 01.03.2023 ku i njëjti ka theksuar ‘‘nga të akuzuarit e njëj N.A pasi që kanë punuar bashkë me të në mishtore si dhe e njëj të akuzuarin S.K po ashtu ka shtuar se nuk është furnizuar me narkotik nga te akuzuarit përveç se me përdor po dhe atë me N, kemi pi bashke marihuane gjatë kohës qe kemi punuar, ndërsa nuk jemi furnizuar nga një person i caktuar kah kemi mujt jemi furnizuar ’’ dëgjimi i dëshmitarit **B.B** të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 01.03.2023 i cili ka deklaruar se ‘‘njihet vetëm me N.A se një kohë të gjatë ka punuar kasap para shumë kohesh, me të cilin shoqërohet rrallë, dhe se ka marrë marihuane për përdorim personal se kam qenë përdorues për periudhë kohore dy vite, ndërsa ka njohuri se përdorues i substancave narkotike është edhe N. për të tjetër nuk di, dhe se prej të njëjtit jam furnizuar, nga askush tjetër s’jam furnizuar. Me tej ka shtuar se prej N. një cigare e ka marr për shumën 5 euro, dhe atë rrallë ndonjë herë diku një në dy tri ditë, ndërsa se ku e ka marrë N. nuk di, por me të njëjtin kemi pi bashkë edhe kam marr prej tij dhe kam blerë prej tij po ashtu e kam porositur se kur te blen për vete te merr edhe për mua me çmimin e njëjtë e për çka është dashtë edhe unë me ia dhanë paret N.’’ Nga të gjitha këto dëshmi të dëshmitarëve gjykata vërteton faktin se të akuzuarit N.A dhe N. A. janë njohur shumë më parë, kanë pas një bashkëpunim të ngushtë mes vete, dhe po ashtu të njëjtit kanë konsumuar marihuan, dhe njëkohësisht kanë bashkëpunuar në mes veti me qëllim të shpërndarjes dhe ofrimit për shitje të narkotikëve, rrjedhimisht në mes të akuzuarve ekziston **lidhja objektive** se i akuzuari S.K duke bashkëvepruar me të akuzuarin N.A kanë ndërmarrë veprime duke i kontribuar kryerjes së veprës penale. Të gjitha veprime i kanë ndërmarr pas marrëveshje paraprake për tu takuar të ura ‘‘I.’’ ( pompa e vogël e derivateve), përballë Komunës së P., në atë mënyre i akuzuari S.K me qëllim të shpërndarjes dhe ofrimit për shitje të substancës Narkotike, ia ka ofruar të akuzuarit N. substancën narkotike, andaj pasoja e veprës penale është rezultat i përbashkët i veprimeve të të akuzuarve S. K. dhe N.A. Ndërsa **lidhja subjektive** qëndron në atë se akuzuarit kanë bashkëvepruar me vetëdije për kryerjen e veprës penale ashtu që i akuzuari S. i ka ofruar për shitje substance narkotike me qëllim për shitje dhe shpërndarje të akuzuarit N.A i njëjti të veprëj duke shpërndarë te persona tjerë.

Faktin se të akuzuarit në bashkëkryerje kanë kryer veprat penale blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope nga neni 267 të KPRK-së, ashtu

siç pretendon prokurori në aktakuzë vërtetohet edhe nga provat materiale të cilat janë administruar në shqyrtimin gjyqësor e të cilat janë pjesë e lëndës, siç janë *Raporti i vendit të ngjarjes tek ura 'I.'* (pompa e vogël e derivateve) përballe komunës së P. .... i datës...., nga kjo provë vërtetohet fakti se i akuzuari S.K i dërgon substanca narkotike të llojit kokainë të akuzuarit N.A i cili ka qenë të ura në afërsi të pompës Ina (pompe e vogël e derivateve) përballe Komunës së P., te ura ka ardhur N.A ku e ka pritur S. , përderisa S. ka qenë duke bërë shitjen e substancave narkotike dhe Policia e Kosovës i ka kapur në flagrancë duke shitur substancën narkotike dhe në atë moment S. qesen me narkotik të llojit kokainë e ka hedhur në tokë ndërsa gjatë kontrollës fizike që i është bërë N. të njëjtit i janë gjetur dhe sekuestruar një qese me narkotik të llojit marihuanë. Po ashtu në bazë të vërtetimit për sekuestrim të përkohshëm të sendeve në vendin e ngjarjes, nr. 2020-DHTN-307 të datës 23.09.2023, vërtetohet fakti se i akuzuari S.K ka poseduar substancë narkotike e llojit kokainë në peshë të përgjithshme pre 036=0.0001g, si dhe në shtëpinë e të akuzuarit S.K janë gjetur edhe dy peshore për matjen e substancave narkotike, ndërsa për të akuzuarin B.A në bazë të vërtetimit për sekuestrim përkohshëm të sendeve në vendin e ngjarjes, nr. të datës ..., vërtetohet se i akuzuari N.A ka poseduar substanca narkotike e llojit kanabis në peshë të përgjithshme prej 1.05=0.0001g.

Faktin se të akuzuarit S. K. dhe N.A kanë poseduar substanca narkotike vërtetohet edhe nga *Raporti nga Agjencia e Kosovës për forenzik mbi ekzaminimin e substancave narkotike të gjetura në vendin e ngjarjes tek ura 'I.'* (pompa e vogël e derivateve) përballe komunës së P. t datë e përfundimit ..., nga e cila provë vërtetohet se i akuzuari S.K ka poseduar, një qese plastike të tejdukshme e mbyllur me mbishkrimin L. ...: D. e cila përmban substancë pluhur me ngjyrë të bardhë e llojit kokainë në peshë të përgjithshme pre 0.36 gram, po ashtu nga kjo provë vërtetohet se i akuzuari N.A ka poseduar një qese plastike të tejdukshme e mbyllur me mbishkrimin L. ... e cila përmban substancë bimore me ngjyrë të gjelbër e llojit t kanabis (marihuanë) që përmban tetrahidrokanabinol (THC).

Andaj nga provat materiale dhe personale të administruara në shqyrtim gjyqësor vërtetohet se të akuzuarit në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale si në aktakuzë dhe ky fakt gjënë mbështetje në prova të besueshme –relevante, pasi që bashkëkryerja ekziston “kur dy apo më shumë persona duke marr pjesë në veprimin e kryerjes apo në ndonjë mënyrë tjetër së bashku kryejnë veprën penale,”. Për të ekzistuar kjo formë e bashkëpunimit duhet të plotësohen elementi objektiv, pra si bashkëkryerës është personi i cili së bashku me të tjerët ndërmerr veprimin e kryerjes së veprës penale të caktuar dhe me këtë ekziston lidhja objektive në mes të akuzuarve, të cilët me veprimet e tyre i kanë kontribuar kryerjes së veprës penale, ashtu siç pretendon prokurori në aktakuzë, pasi që siç vërtetohet nga provat personale dhe materiale pasojat e veprës penale të cekura në aktakuzë janë rezultat i përbashkët i veprimeve të të akuzuarve, nga të gjitha këto prova të administruara në shqyrtim gjyqësor vërtetohet se të akuzuarit S. K. dhe N.A kanë ndërmarr veprime me të cilën i kanë kontribuar kryerjes se veprës penale blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope nga neni 267 të KPRK-së, si dhe elementi subjektiv pra si bashkëkryerës është personi i cili së bashku me tjetrin në bazë të marrëveshjes mbi ndarjen e punës realizon pjesën e vet në procesin e kryerjes së veprës penale e ka dëshiruar pasojën dhe veprën penale e konsideron si të veten, po ashtu të gjithë provat personale dhe materiale vërtetonin faktin se ekziston lidhja subjektive në mes të pandehurve, për faktin se të njëjtit kanë pasur dijeni për njeri tjetrin, e që janë njohur personalisht me njeri tjetrin për faktin se të njëjtit Policia e Kosovës i ka zanë në flagrancë, ashtu që N.A ka nxjerr nga xhepi të hollat për pagesë të narkotikut, të akuzuarit S.K dhe po ashtu vërtetohet fakti se të njëjtit janë marr vesh mbi ndarjen e punës për realizimin e pjesës së vet në procesin e kryerjes së veprës penale dhe se veprën penale e kanë konsideruar të veten.

Gjykata vlerësoi me shumë kujdes të gjitha provat e administruara në shqyrtim gjyqësor dhe ka ardhur në përfundim se duhet t’iu falet besimi i plotë provave personale siç janë siç janë, deklarata e dëshmitarit B. B., deklarata e dëshmitarit Riza Ruli, nga këto dëshmi te lartcekura pa mëdyshje gjykata vërteton faktin se i akuzuari S.K ka poseduar substanca narkotike me qëllim shitje dhe shpërndarje ndërsa i akuzuari N.A ka blerë narkotiket nga i akuzuari S. me qëllim të shitjes dhe shpërndarjes këtë fakt gjykata e vërteton edhe nga dëshmia e dëshmitarit B. B. të dhënë në shqyrtim gjyqësor i cili ka theksuar ‘‘ se prej N. një cigare e ka marr për shumën 5 euro, dhe atë rrallë ndonjë herë diku një në dy tri ditë, ndërsa se ku e ka marrë N. nuk di, por me të njëjtin kemi pi bashkë edhe kam marr prej tij dhe kam blerë prej tij po ashtu e kam porositur se kur te blen për vete te merr edhe për mua me çmimin e njëjtë e për çka është dashtë

edhe unë me ia dhanë parat N.” po ashtu nga dëshmia e dëshmitarit R.R vërtetohet fakti se ‘ prej N. një cigare e ka marr për shumën 5 euro’, nga dëshmia e dëshmitarit V.M vërtetohet fakti se ‘ me N, kemi pi bashke marihuane gjatë kohës që kemi punuar, ndërsa nuk jemi furnizuar nga një person i caktuar kah kemi mujt jemi furnizuar’ Andaj, këto dëshmi konsiderohen të besueshme dhe se këto dëshmi kanë mbështetje edhe në provat e administurara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe të njëjtave i’ua fali besimin e plotë, prandaj gjykata gjen se provat e bashkangjitura aktakuzës në mënyre të pa dyshim vërtetojnë se të akuzuarit në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope nga neni 267 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Nga këto dëshmi pa mëdyshje gjykata vërteton faktin se të akuzuarit S.K dhe N.A në bashkëkryerje kanë kryer veprën **penale blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope** si dhe duke i analizuar provat materiale të cilat i ka administruar në shqyrtimin gjyqësor i ka vlerësuar si prova të pranueshme andaj i ka administruar si të tilla, të cilëve kjo gjykatë u kushtoi besim të plotë, e të cilat qojnë gjykatën në konkludim se besueshmëria në to dhe shkalla e arsyesh mërisë me rrethanat e konkrete të rastit, në mënyrë të padyshimtë vërtetojnë që të akuzuarit në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope nga neni 267 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata duke analizuar dispozitën ligjore të nenit 267 par. 1, e cila shprehimisht parasheh se ‘. **Kushdo që pa autorizim blen ose posedon me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, ose ofron për shitje substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope apo substanca analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vjet**’. Sipas analizës të kësaj dispozite janë paraparë dy forma themelore të kësaj vepre penale: **blerja pa autorizim** dhe **posedimi pa autorizim** me qëllim të shitjes, shpërndarjes a ofrim për shitje narkotikë të *shpallura me ligj*, substanca psikotropike apo substanca analoge. Përkatësisht e përbashkëta e këtyre dy formave të kësaj vepre penale është, se janë të drejtuara kundër objektit të përbashkët mbrojtës, se kryhen pa autorizim, se e kanë mjetin e përbashkët të kryerjes, pra pasoja e veprës është e njëjtë dhe se të dy format kryhen **vetëm me dashje**. Kjo gjendje faktike vërtetohet se në veprimet e të akuzuarve janë manifestuar elementet e veprës penale si formë themelore **blerja e paautorizuar dhe posedimi pa autorizim** me qëllim të shitjes shpërndarjes a ofrimi për shitje të narkotikëve, gjegjësisht me veprimet e të akuzuarve janë konsumuar elementet e veprës penale kjo për faktin se të njëjtit me dashje kanë vepruar pa autorizim në mënyre të kundërligjshme duke qene të vetëdijshëm se nuk posedojnë autorizim të posaçëm për blerjen apo posedimin e narkotikëve substanca psikotropike a preparateve të shpallura të rrezikshme me qëllim shitje, shpërndarje apo ofrim shitje si dhe faktin se të akuzuarit janë zënë në flagrancë ku i akuzuari S.Ki ka ofruar të akuzuarit B.Asubstancë narkotike të llojit kokainë, me qëllim që iu njëjti ti shes personave të tjerë.

Gjykata duke analizuar dhe vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të **S. K av. B. T.**, të dhënë në shqyrtimin gjyqësor, ka konstatuar se pretendimi është dhënë në drejtim të shmangies nga përgjegjësia penale, kjo pasi që është në kundërshtim të plotë me provat materiale dhe personale të cilat i ka bashkangjitur prokuroria në aktakuzë e të cilat gjykata i dha besim të plotë, ndërsa pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit dhe të akuzuarit se kinëse ‘ e kundërshtonë ne tersi arsyetimin e PSRK-se, dhe konsiderojmë që pas analizimit konstatimit dhe sintetizimit të tërësishëm të pretendimeve PSRK mbrojtjes dhe të provave të administruar, logjikshëm , rrjedhshëm e përtej çdo dyshimi është vërtetuar e pa bazuar aktakuza. Sa i përket qeses se najlonit që është gjetur në shtëpinë e të pandehurit përveç se pluhuri që ka rezultuar lende narkotike në një sasi të vogël e që i pandehuri nuk e ka kontestuar që është apo nuk është lende narkotike dhe nga aspekti që është kryefamiljar sipas traditës është deklaruar se çdo gje që mund të gjendet brenda territorit që e ka në kontroll , formal edhe pse kontrolli faktik don kushte tjera, në e kundërshtojmë akuzën , nuk e pranon përgjegjësin sepse kryefamiljari nuk bart përgjegjësi penale, ngjashëm me përgjegjësin objektive, ndërsa lidhur me akuzën për shitje të lendes narkotike si qeshte përshkruar në dipspozitiv dhe fjalë përfundimtare e kundërshtojmë të pa bazuar sepse nuk vërtetohet me asnjë prove , e vetmja prove që nuk prodhon efekt juridik është deklarata e bashke të pandehurit e dhëne në polici, andaj po të ishte deklaruar i pandehuri para gjykatës dhe t’kishin mundësi që ta intervistonin do të vërtetohej fakti që deklarata e tij ka qenë në afekt dhe me qëllim të shmangies se vetvetes nga

*përgjegjësia penale. Andaj pasi që konfrom dispozitive te Kodit te Procedurës Penale i pandehuri nuk shpallet fajtor vetëm me një prove dhe nuk mund te shpallet fajtor me deklaratën e te bashkëpandehurit ne te njëjtën procedure, ndërsa provat tjera nuk e vërtetojnë veprën dhe përgjegjësin penale, andaj veprimet e te pandehurit ashtu qysh i kemi theksuar edhe ne fazat e me hershme as individualisht e as ne tërësi nuk përbejnë figurën e veprës për te cilën është akuzuar e as për ndonjë vepër tjetër penale'' te njëjta i hodhi poshtë si të pa besueshme dhe të pabazuara, për faktin se i akuzuari ka vepruar në kundërshtim me ligjin ashtu që pa autorizim ne mënyre të kundërligjshme duke qene i vetëdijshëm se nuk posedon autorizim të posaçëm për blerjen apo posedimin e narkotikëve substanca psikotropike a preparateve të shpallura të rrezikshme me qëllim shitje shpërndarje a ofrim për shitje duke i ofruar të akuzuarit B.A substancë narkotike të llojit kokainë.*

Gjykata duke analizuar dhe vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit **N.A av.H. L.**, të dhënë në shqyrtimin gjyqësor sa i përket pikës I të dispozitivit të aktakuzës, ka konstatuar se pretendimet janë dhënë në drejtim të shmangies nga përgjegjësia penale, kjo pasi që është në kundërshtim të plotë me provat materiale dhe personale të cilat i ka bashkangjitur prokuroria në aktakuzë e të cilat gjykata i dha besim të plotë, ndërsa pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit dhe të akuzuarit se kinëse *“ se i mbrojturi im ka N.A e ka pranuar fajësinë, është përdorues i marihuanës të cilën e ka blerë të S. K.. Tani e ka ndërpre nuk e përdor nuk e konsumon ma marihuanen, për çka e ka pi se bashku me dëshmitaret Berat B., V. M. dhe R. R.i. Tutje ka theksuar se nuk është e vërtet se dëshmitarëve ua ka shitur narkotikun-marihuanën kur ka blerë për vete ka blerë edhe për B.B sipas kërkesës së tij. Po ashtu nuk është e vërtete se narkotikun ia ka shitur V. M. e R.R., të cilët edhe në gjykatë deklaruan se nuk kanë blerë narkotik nga N.A, pasi që N. A. e ka gjendjen e rëndë ekonomike e sociale, i njëjti banon me qira, bashkëshorten ka studente dhe ka dy fëmijë të mitur, njërin fëmijë e ka të sëmur me aftësi të kufizuara të përhershme. Provë-Aktvendimi i KK-P.’’”, te njëjta i hodhi poshtë si të pa besueshme dhe të pabazuara, për faktin se në rastin konkret i akuzuari N.A është zënë në flagranc duke blerë substancën narkotike nga i akuzauri S.K fakt i cili është vërtetuar edhe nga provat personale dhe materiale si dhe fakti se i njëjti ka vepruar në kundërshtim me ligjin ashtu që pa autorizim ne mënyre të kundërligjshme duke qene i vetëdijshëm se nuk posedon autorizim të posaçëm për blerjen apo posedimin e narkotikëve substanca psikotropike a preparateve të shpallura të rrezikshme me qëllim shitje shpërndarje a ofrim për shitje.*

Andaj nga sa u tha më lart, gjykata duke pasur parasysh të gjitha provat e proceduara, faktet dhe rrethanat e vërtetuar në shqyrtim gjyqësor, ka vërtetuar se të akuzuarit S.K dhe N.A kanë kryer veprën penal si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që i njëjtit kanë konsumuar elementet e veprës penale blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope nga neni 267 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

## II.

Gjykata në vështrim të nenit 360 par. 1 dhe 2 të KPP-së, aktgjykimin për të akuzuarit **P. C. dhe B.C** e bazoj në faktet dhe në provat e administruara në shqyrtim gjyqësor të cilat prova i vlerësoi me ndërgjegje një nga një dhe në lidhje me provat e tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë erdhi në përfundim se të njëjtit në bashkëkryerje kanë kryer veprën kanë kryer veprën penale blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope nga neni 267 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor ka vërtetuar se me datë 02.10.2021 rreth orës 08:20 në shtëpinë e përbashkët të të akuzuarve P.C dhe B.C gjatë bastisjes së shtëpisë së tyre në rr. "F. H.", L.G., nr., P., është gjetur një peshore elektronike, një qese plastike e tejdukshme e cila përmban substancë narkotike, tri qese plastike te tejdukshme e mbyllur të cilat përmban substancë bimore ngjyrë të gjelbër me peshë 4.61 gram, një qese plastike te tejdukshme e mbyllur e cila përmban substanc bimore ngjyrë të gjelbër me peshë 2.53 gram, një qese plastike te tejdukshme e mbyllur e cila përmban substanc bimore ngjyrë të gjelbër me peshë 2.07 gram, ku të akuzuarit në bashkëveprim në mënyrë të kundërligjshme dhe pa autorizim kanë poseduar me qëllim të shpërndarjes dhe ofrimit për shitje të substancës narkotike të llojit kanabis (marihunë) që përmban tetrahidrokanabinol (THC) në peshë të përgjithshme prej 9.21=0.0001g.

Këtë gjendje faktike gjykata e vërtetoi nga provat materiale të cilat janë administruar në shqyrtimin gjyqësor e të cilat janë pjesë e lëndës, përkatësisht ***vërtetimi për sekuestrim të përkohshëm të sendeve i datës ...***, me të cilën provë vërtetohet fakti se në shtëpinë e përbashkët të të akuzuarve P. dhe B.C është gjetur një (1) qese najloni me ngjyrë të kaltër mbetje pluhur të bardhë me substancë narkotike, si dhe tre (3) mbështjellës plastike me substancë narkotike marihuanë, si dhe një peshore elektrike QZ 161. ***Nga Raporti i Agjencionit të Kosovës për Forenzik mbi ekzaminimin e substancave narkotike të gjetura në shtëpinë e të akuzuarve Petrit dhe B.C me datë përfundimi ...***, nga kjo provë vërtetohet fakti, në shtëpinë e të akuzuarve janë gjetur, substanca narkotike në të cilën provë është konstatuar “ *dëshmia #2 një qese plastike e tejdukshme me mbishkrim .. e cila përmban një letere me ngjyrë të bardhë me mbishkrim ....., të ndara në tri qese dhe atë dëshmia #2.1 një qese plastike te tejdukshme e mbyllur e cila përmban substancë bimore ngjyrë të gjelbër me peshë 4.61 gram, dëshmia #2.2 një qese plastike te tejdukshme e mbyllur e cila përmban substancë bimore ngjyrë të gjelbër me peshë 2.53 gram, dëshmia #2.3 një qese plastike te tejdukshme e mbyllur e cila përmban substancë bimore ngjyrë të gjelbër me peshë 2.07 gram me peshë të përgjithshme prej 9.21=0.0001g.*

Fakti se të akuzuarit P. C. dhe B.C në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope nga neni 267 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, vërtetohet edhe nga ***raporti informues dhe transkripti i bisedave për të akuzuarit P.C dhe B.C me nr ... DT....*** nga e cila provë vërtetohet se i akuzuari P.C bisedon me persona të tjerë për sigurimin e narkotikut ku në këtë bisedë është theksuar se “ ***P.C i kthen përgjigj personit NNP duke i thënë se veç 100 gram i kam ndërsa personi NNP i thotë po vij se s'kam qare pa ardhë***” po ashtu nga transkripti i dt ... bisedohet rreth narkotikut ku ***P.C dhe personi NNP- (dyskohet të jetë) B.C*** diskuton dhe në këtë bisedë është theksuar se “ *ai burri me tha na ju lamerojmë kur me ardh, në atë javën tjetër le të bahet gati me shku mi lamjëru, i lanë sendet zhag për qata s'janë gati ndërsa P.C i drejtohet me fjalët Qu prej aty hajde, rras .....* le të shkojnë te mirren me punë tjetër, hajde te unë. Nga këto prova vërtetohet fakti se ekziston lidhja objektive në mes të pandehurve, Petrit dhe B.C të njëjtit kanë ndërmarr veprime dhe i kanë kontribuar kryerjes së veprës penale blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope nga neni 267 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, pasi që siç vërtetohet nga këto prova pasojat e veprave penale të cekura si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi janë rezultat i përbashkët i veprimeve të të akuzuarve, dhe se ekziston lidhja subjektive në mes të akuzuarve, për faktin se të njëjtit kanë pasur dijeni për njeri tjetrin, se të njëjtit janë vëllezër, ***dhe po ashtu vërtetohet fakti se të njëjtit janë marr vesh mbi ndarjen e punës për realizimin e pjesës së vet në procesin e kryerjes së veprës penale dhe se veprën penale e kanë konsideruar si të veten.*** Nga raporti informues i datës 02.06.2023 përkatësisht transkripti i datës ..., vërtetohet fakti se të akuzuarit P.C dhe B.C janë dakorduar që duhet pritur personin deri në njoftim “ *ai burri me tha na ju lajmërojmë kur me ardh në atë javën tjetër le të bëhet gati* ”, si dhe faktin nga biseda ... i dt. ... nga e cila provë vërtetohet se i akuzuari P.” ***një here nuk ka si të ka apo furnizohet do të lajmëron personin*** “ pra nga kjo provë vërtetohet se të akuzuarit Besart dhe Petrit pa autorizim kanë poseduar substanca narkotike për qëllim shitjen, shpërndarje tek persona tjerë, pasi që substanca narkotike është gjetur në shtëpinë e tyre në qese të ndara dhe të paketuara si dhe faktin se tek të njëjtit është gjetur edhe peshorja për matje të substancave, ashtu që të njëjtit në bashkëkryerje kanë vepruar duke konsumuar elementet objektive dhe subjektive të veprës penale blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope nga neni 267 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, elementi i figurës se kësaj veprës penale është ***pa autorizim*** pra të akuzuarit pa autorizim dhe duke qenë të vetëdijshëm se nuk posedojnë autorizim të posaçëm për blerjen apo posedimin e narkotikëve substanca dhe si mjet për kryerjes se veprës penale janë substancat narkotike e të cilat janë të shpallura të rrezikshme për shëndetin e njeriut, dhe pasojë e veprës penale është rrezik jeta dhe shëndeti i njeriut. Gjykata pas analizimit të provave materiale e të administruara në shqyrtim gjyqësor vie në përfundim se të akuzuarit janë përgjegjës për veprimet e ndërmarrja dhe se të njëjtit me veprimet e tyre i kanë konsumuar elementet e kësaj vepre penale. Po ashtu për të ekzistuar forma e bashkëpunimit duhet të plotësohen elementi objektiv, ***pra si bashkëkryerës është personi I cili së bashku me të tjerët ndërmerr veprimin e kryerjes së veprës penale të caktuar*** si dhe elementi subjektiv ***pra si bashkëkryerës është personi I cili së bashku me tjetrin në bazë të marrëveshjes mbi ndarjen e punës realizon pjesën e vet në procesin e kryerjes së veprës penale e ka dëshiruar pasojën dhe veprën penale e konsideron sit ë veten.*** Siç është

theksuar edhe më lartë për tu konsideruar e kryer kjo veprë penale, veprimi i kryerësit është përcaktuar në mënyrë alternative kryerësi i saj duhet që në mënyrë alternative ti ndërmerr veprimin ashtu që veprën penale e kryen ai që shet mallin, sendin apo shërbimin pa autorizim, d.m.th. kryerësi duhet të ndërmerr ndonjërin nga këto veprime pa pasur autorizim për një veprim të tillë nga organi kompetent. Gjykata konsideron se të akuzuarit **B.C dhe P.C** në raport me elementet e veprës penale, kanë konsumuar në tërësi me veprimet e tyre elementet inkriminuese të veprës penale, pasi që të pandehurit B. dhe P.C kanë poseduar pa autorizim me qëllim të shitjes shpërndarjes të substancave narkotike e të cila substanca sipas ligjit janë të ndalura, nga këto veprime konsumohet elementi i veprës penale **blerja e paautorizuar dhe posedimi pa autorizim** ku të akuzuarit substancat narkotike i kanë ndarë dhe paketuar ne qese me qëllim të shitjes së tyre të persona të ndryshëm, nga këto veprime konsumohet elementi i veprës penale **blerja e paautorizuar dhe posedimi pa autorizim** mirëpo të njëjtit me urdhër të Gjykatës Themelore – Departamenti Special PPPS.nr. 25/20 dhe PPPS.nr.19/2021 kanë qenë në masa të fshehta të përgjimit të telekomunikimeve përmes numrave të telefonit janë identifikuar të akuzuarit P. dhe B.C dhe gjatë bisedave të tyre janë zbuluar që të njëjtit kanë biseduar për substanca narkotike për vlerën dhe sasinë që e marrin e cila vlerë ka qenë në lartësi prej 100 deri në 150 euro, sipas analizës së kësaj dispozite për ekzistimin e kësaj veprë penale duhet të ekzistoi **DASHJA**, si element qenësor, e cila përfshinë edhe dijeninë e kryerësit përkatësisht të akuzuarit kanë qenë në dijeni se nuk kanë autorizim të veçantë që të posedojnë dhe shpërndajnë substanca narkotike.

Gjykata vërtetoi faktin se në mes të akuzuarve ekziston **lidhja objektive** për të ndërmarrur veprim i cili i ka kontribuar kryerjes së veprës penale, pasi që siç vërtetohet pasojat e veprës penale janë rezultat i përbashkët i veprimeve të të akuzuarve. Po ashtu vërtetohet fakti se ekziston edhe **lidhja subjektive** në mes të akuzuarve, për faktin se të njëjtit kanë pasur dijeni për njeri tjetrin, dhe janë njohur personalisht me njeri tjetrin dhe se të njëjtit janë vëllezër, **dhe po ashtu vërtetohet fakti se të njëjtit janë marr vesh mbi ndarjen e punës për realizimin e pjesës së vet në procesin e kryerjes së veprës penale dhe se veprën penale e kanë konsideruar si të veten.**

Gjykata duke analizuar dispozitën e veprës penale, blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope nga neni 267 par. 1, e cila shprehimisht parasheh se “**Kushdo që pa autorizim blen ose posedon me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, ose ofron për shitje substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope apo substanca analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vjet**”. Sipas analizës të kësaj dispozite janë paraparë dy forma themelore të kësaj veprë penale: **blerja pa autorizim** dhe **posedimi pa autorizim** me qëllim të shitjes, shpërndarjes a ofrim për shitje narkotikë të **shpallura me ligj**, substanca psikotropike apo substanca analoge. Përkatësisht e përbashkëta e këtyre dy formave të kësaj veprë penale është, se janë të drejtuara kundër objektit të përbashkët mbrojtës, se kryhen pa autorizim, se e kanë mjetin e përbashkët të kryerjes, pra pasoja e veprës është e njëjtë dhe se të dy format kryhen **vetëm me dashje**. Kjo gjendje faktike vërtetohet se me veprimet e tyre janë manifestuar elementet e veprës penale si formë themelore **blerja e paautorizuar dhe posedimi pa autorizim** me qëllim të shitjes shpërndarjes a ofrimi për shitje të narkotikëve, gjegjësisht me veprimet e të akuzuarve janë konsumuar elementet e veprës penale kjo për faktin se të njëjtit me dashje kanë vepruar pa autorizim në mënyrë të kundërligjshme duke qenë të vetëdijshëm se nuk posedojnë autorizim të posaçëm për blerjen apo posedimin e narkotikëve substanca psikotropike a preparateve të shpallura të rrezikshme me qëllim shitje, shpërndarje apo ofrim shitje si dhe faktin se të akuzuarit substancat narkotike i janë gjetur në shtëpi, vërtetohet edhe nga **Fotoalbumi nga vendi i ngjarjes- në shtëpinë e të akuzuarve Petrit dhe B.C** nga kjo provë vërtetohet se të akuzuarit e lartpërmendur në shtëpinë e tyre të përbashkët kanë poseduar substanca narkotike pa autorizim me qëllim të shitjes, fakt që vërtetohet nga fotoalbumi i datë 02.10.2021 prova me nr.4 shifet një qese plastike me ngjyrë të kaltër me mbetje të substancës narkotike dhe një peshore elektrike me nr. ...., si dhe fotografia nr.11 e cila mban numrin 3 si dëshmi shifet qartë që substanca narkotike është ndarë në qese me qëllim të shitjes dhe shpërndarjes të personat tjerë, po ashtu nga dëshmia nr. 12 e cila përmban numrin 3 shifet se substanca është paketuar në qese plastike të ndara fakt që vërtetohet edhe nga raporti i ekspertimit nga e cila provë vërtetohet se substancat narkotike kanë qenë të paketuara në qese të ndara gjendje faktike që vërtetohet nga dëshmia nr. #2 ku është bërë paketimi në tri qese, dëshmia #2.1 një qese plastike të tejdukshme e mbyllur e cila përmban substancë bimorë ngjyrë të gjelbër me peshë 4.61 gram, dëshmia #2.2 një qese plastike të tejdukshme e mbyllur e cila përmban substancë bimorë ngjyrë të gjelbër me peshë

2.53 gram, dhe dëshmia #2.3 një qese plastike te tejdukshme e mbyllur e cila përmban substancë bimore ngjyrë të gjelbër me peshë 2.07 gram, pra substanca narkotike e paketuar në sasi të caktuara me qese të ndara e paketime dhe ndarja është bërë me qëllim të shitjes dhe shpërndarjes. Andaj gjykata provat materiale të lartpërmendura e të administruar në shqyrtim gjyqësor e të cilat janë pjesë të shkresave të lëndës ua fali besimin e plotë pasi që të njëjta janë marrë në përputhje me dispozitat ligjore andaj i ka administruar si të tilla.

Gjykata duke analizuar dhe vlerësuar pretendimin e mbrojtësit të të akuzuarit *P.C v. G. C.* ka konstatuar se mbrojtja e dhënë është në drejtim të shmangies nga përgjegjësia penale, kjo pasi që është në kundërshtim të plotë me provat materiale të cilat gjykata i ka administruar në shqyrtimin gjyqësor e të cilat gjykata i dha besim të plotë, ndërsa pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit *P.C av. G. C.* se kinse *‘me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk është provuar përtej dyshimit të bazuar se i mbrojturi im e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Në veprimet e tij nuk manifestohen asnjëri nga elementet qenësore që përbëjnë figurën e veprës penale për të cilën akuzohet, sepse nga gjendja e vërtetuar e fakteve nuk del se ekzistojnë prova të cilat tregojnë se P.C e ka kryer veprën penale të përshkruar në dispozitiv të Aktakuzës. Nga gjendja e provave nuk del se ai kishte ndërmarr çfarëdo veprimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me qëllim të kryerjes së veprës penale me të cilën akuzohet. Me tej ka theksuar se gjykatës i vë në pah disa fakte të rëndësishme të cilat duhet t'i ketë parasysh me rastin e marrjes së vendimit për fajësinë apo pafajësinë e P.C Po ashtu bazuar në nenin 119, par. 2 i KPPRK-së: Provat e siguruara gjatë marrjes në pyetje në procedurë paraprake mund të përdoren si bazë për të forcuar urdhrat hetues në procedurë paraprake, vendimet për paraburgim dhe aktakuzën. Provat e siguruara gjatë marrjes në pyetje në procedurë paraprake nuk mund të përdoren si provë e drejtpërdrejtë gjatë shqyrtimit kryesor, por mund të përdoren gjatë marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje, marrjes së tërthortë në pyetje dhe rimarrjes në pyetje, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë Kod. Po ashtu Prezumimi i Pafajësisë dhe Barra e të Provarit, janë të artikuluar në të gjitha konventat kryesore ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut dhe janë të mishëruara edhe në nenin 3 të KPPRK-së (Prezumimi i pafajësisë i të pandehurit dhe in dubio pro reo) dhe në nenin 7, par. 1 të KPPRK-së (Detyrimi i përgjithshëm për vërtetimin e plote dhe te sakte te fakteve). Tutje ka shtuar se gjatë shqyrtimit gjyqësor u vërtetua se Prokuroria, gjatë hetimit e po ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, provat i ka vlerësuar në mënyrë të njëanshme dhe selektive duke i marrë për bazë dhe duke i vlerësuar vetëm ato prova dhe fakte të cilat ka besuar se shkojnë në favor të Aktakuzës, e jo edhe provat dhe faktet që shkojnë në favor të mbrojtjes. Po ashtu mbrojtja vlerëson se Aktakuza e Prokurorisë është ndërtuar në kundërshtim me nenin 235 par 1.7 të KPPRK-së, sepse Prokuroria në dispozitiv të Aktakuzës nuk ka dhënë shpjegimet e mjaftueshme të arsyeve për ngritjen e Aktakuzës. Si dhe kjo nuk është bërë edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor sepse aktakuzës i mungojnë referenca të qarta të provave në lidhje me faktet vendimtare. Nga te cekurat me lart prokuroria nuk ka dhënë asnjë vlerësim, e po ashtu edhe një arsye të vetme se më cilat prova ka vërtetuar se P.C ka kryer veprën penale të përshkruar në dispozitiv të Aktakuzës. Po ashtu, në arsyetimin e Aktakuzës, Prokuroria nuk ka dhënë asnjë vlerësim të vetin lidhur me saktësinë e provave dhe lidhjen kauzale në mes tyre dhe veprimeve të të pandehurit. Prandaj arsyetimi i aktakuzës dominohet me shpjegime nga rast tjetër i cili nuk ka të bëjë fare me rastin në fjalë dhe për të cilin janë pushuar hetimet, pastaj në arsyetim janë të përfshira deklaratat e dëshmitarëve dhe të akuzuarve, por që kërkohet nga ligji që prokuroria t'i shpjegoj përmes analizës se cilat janë arsyet për ngritjen e aktakuzës, mungojnë dhe nuk janë ofruar nga prokuroria. Për këtë arsye aktakuza nuk e plotëson kushtin nga neni 235 par. 1.7 i të KPPRK-së. Nga ana tjetër prokuroria e ngarkon P.C që në bashkëveprim me vëllain e tij B.C kanë kryer veprën penale blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope nga neni 267 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. I njëjti ka theksuar se figura e kësaj vepre penale përbëhet nga disa elemente esenciale. Elementi i parë i kësaj vepre penale është blerja e narkotikëve, substancave psikotrope a substancave analoge të rrezikshëm me qëllim të shitjes, shpërndarjes ose ofrimit për shitje, ndërsa elementi i dytë i kësaj vepre penale është posedimi i narkotikëve, substancave psikotrope vetëm për qëllim të shitjes, shpërndarjes a ofrimit për shitje. Pra vepra penale për të cilën ngarkohet i pandehuri ekziston vetëm nëse narkotikët, substancat psikotrope a preparatet e shpallura të rrezikshme blihen ose posedohet vetëm për shitje, shpërndarje a ofrim për shitje. Ndryshe nëse i pandehuri blen ose posedon narkotikë, substanca psikotrope a preparate të shpallura të rrezikshme, për qëllim të shitjes, shpërndarjes a ofrimit për shitje, atëherë nuk do të ekzistoj kjo vepër penale. Andaj i mbrojturi im, në të gjitha deklaratat e tij në të gjitha fazat e procedurës, nuk e*



ka mohuar faktin e posedimit të substancës narkotike dhe atë për nevoja të vëllait të tij, pasi që ai edhe për shkak të problemeve psikike, është konsumues i substancave të tilla dhe është në terapi të shërimit dhe pastrimit. Me tej ka shtuar se prokuroria e ka obligim ligjor që me prova materiale, e personale, të vërtetoj përtej dyshimit të bazuar mirë se i mbrojturi im ka kryer veprimin e blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe të substancave psikotrope. D.m.th. nëse i mbrojturi im është shitësi, atëherë për ne dhe gjykatën duhet ditur kush është blerësi. Nëse i mbrojturi im është shpërndarësi, atëherë duhet dituri destinacioni, vendi i shpërndarjes, porositi apo edhe pranuesi i mallit etj. Nëse i mbrojturi im e ka poseduar për qëllime të shitjes apo shpërndarjes, atëherë duhet të identifikohet blerësi i mundshëm, apo rrugët e shpërndarjes. Të gjitha këto veprime duhet të provohen përtej dyshimit të bazuar mirë me prova materiale, dëshmitarë etj, e jo të mbetet vetëm në nivelin e dyshimit dhe spekulimit. Pra nga provat materiale dhe personale të administruara në shqyrtim gjyqësor nuk është vërtetuar në asnjë rast këto elemente në mënyrë që të ndërtohej figura e veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri P. C.. Duke marr parasysh se prokuroria ka propozuar që të dëgjohen në cilësinë e dëshmitarit, dëshmitarët B.B.i, V.M dhe R. R.. Që të tre këta dëshmitar janë dëgjuar në seancën e shqyrtimit kryesor dhe ne pyetjen e mbrojtjes se a e njihni të pandehurin P.C që të tre pa asnjë hezitim, janë shprehur se nuk e njohim. Dëshmitarët janë ftuar nga prokuroria me qëllim të vërtetimit të elementit të shitjes së substancave narkotike pasi që të njëjtit edhe ishin konsumues të tyre. Andaj nga dëshmia e dëshmitareve të lart përmendur i vetmi fakt që është provuar apo vërtetuar është se dëshmitarët kanë konsumuar substanca narkotike, ose edhe e kanë blerë atë nga i pandehuri i dytë N.A, por në asnjë rast nga i pandehuri P. C.. Si përfundim i njëjti ka theksuar se Prokuroria e Shtetit pa dhënë shpjegimin e mjaftueshëm të arsyeve për ngritjen e aktakuzës, pa referenca të qarta në provat që vërtetojnë faktet kryesore, pa e vlerësuar besueshmërinë ose jo të provave, gabimisht, në mënyrë selektive dhe të njëanshme, i ka marr si të mirëqena vetëm ato prova të cilat shkojnë në favor të aktakuzës, por jo edhe deklaratat dhe mbrojtjen e të pandehurit e cila në tersi është në favor të mbrojtjes” Trupi gjykues deklarimet e tilla i hodhi poshtë si të pa besueshme, për faktin se të gjitha provat materiale të administruara në shqyrtimin gjyqësor dhe të elaburuara si më lart vërteton faktin se i akuzuari P.C në bashkëkryerje me të akuzuarin B.C kanë kryer veprën penale si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për faktin se provat materiale janë siguruar ligjërisht me masa të urdhëruara sipas Kodi dhe të cilat janë të pranueshme dhe si të tilla janë administruar në shqyrtim gjyqësor si dhe faktin provat e propozuar gjejnë mbështetje edhe në nenin 333 par.3 të KPPRK, e të cilat gjykata i ka administruar në shqyrtim gjyqësor si dhe faktin provat e siguruar janë në përputhje edhe me dispozitën ligjore 256 në par. 2 dhe 3 të KPPRK, në të cilën dispozitë është përcaktuar **“2. Marrja në pyetje në procedurë paraprake mund të përdoret si provë në pajtim me nenin 119 paragrafit 2 të këtij Kodi. 3. Deklarata në procedurë paraprake mund të përdoret si provë në pajtim me nenin 119, paragrafit 3 të këtij Kodi”**.

Gjykata duke analizuar dhe vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit B.C av të dhënë në shqyrtimin gjyqësor sa i përket kësaj pike të aktakuzës, ka konstatuar se pretendimet janë dhënë në drejtim të shmangies nga përgjegjësia penale, kjo pasi që është në kundërshtim të plotë me provat materiale dhe personale të cilat i ka bashkangjitur prokuroria në aktakuzë e të cilat gjykata i dha besim të plotë, ndërsa pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit dhe të akuzuarit se kinëse” nëse i referohemi aktakuzës respektivisht dispozitivit të aktakuzës e njëjta është e mangët dhe e njëjta nuk është përpiluar në pajtim me nenin 241 par. 1 pika 1.4 meqenëse nuk janë përshkruar të gjitha rrethanat faktike që përcaktojnë me saktësi veprën penale që e ka krye i mbrojturi im B.C Me tej ka theksuar se në këtë çështje juridiko penale mungon dyshimi i bazuar mirë si kusht esencial për ngritjen e aktakuzës, andaj në këtë aktakuzë mungojnë prova relevante dhe të pranueshme që të bind gjykatën që një vepër penale ka ndodhur dhe që është kryer nga i mbrojturi im B.C Po ashtu në se i referohemi veprës penale në pikën II të dispozitivit të aktakuzës, është relevante të ceket se substancat narkotike tri qese të najlonit të llojit marihuanë janë gjet në shtëpinë e P.C dhe B.C po ku jeton edhe vëllai tjetër i tyre T. C.por dhe babai i tyre F. dhe nëna e tyre, pra nga ky fakt parashtrohet pyetja si vijon: Nëse i referohemi Kapitullit II të Kodit Penal -Veprat penale dhe përgjegjësia penale dhe atë nenit 17 të Kodit penal është përgjegjësi individuale. Trupi gjykues deklarimet e tilla i hodhi poshtë si të pa besueshme, për faktin se i akuzuari B. C., në rastin konkret duke qene i vetëdijshëm se nuk posedon autorizim të posaçëm për blerjen apo posedimin të substancave narkotike si dhe faktin nga **raporti informues dhe transkripti i bisedave**, përkatësisht

transkripti i datës ..., të akuzuarit P.C dhe B.C janë dakorduar që duhet pritur personin deri në njoftim ‘ ai burri me tha na ju lajmërojmë kur me ardh në atë javën tjetër le të bëhet gati ’ andaj bazuar në provat materiale të administruara në shqyrtimin gjyqësor dhe të elaburoara si më lart vërtetojnë faktin se i akuzuari B.C në bashkëkryerje me të akuzuarin P.C kanë kryer veprën penale si në pikën II të dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi me shumë kujdes të gjitha provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, sa i përket të akuzuarve **P.C dhe B.C** dhe ka ardhur në përfundim se duhet t’i falet besimi i plotë, provave materiale të administruara në shqyrtimin gjyqësor siç janë, Fotoalbumi nga vendi i ngjarjes- në shtëpinë e të akuzuarve P. dhe B.Ci datës ..., Vërtetimi për sekuestrim të përkohshëm të sendeve në shtëpinë e të akuzuarve Petrit dhe B.C Raporti nga Agjencia e Kosovës për Forenzik mbi ekzaminimin e substancave narkotike të gjetura në shtëpinë e të akuzuarve P. dhe B.C me datë përfundimi ..., Raporti informues me transkriptë të akuzuarit P.C me nr ..., si dhe shkresat e tjera të cilat janë pjesë e shkresave të lëndës. Andaj, gjykata këto dëshmi i konsideroi të besueshme, dhe të njëjtave ua fali besimin.

Gjykata duke pasur parasysh të gjitha provat e proceduara, faktet dhe rrethanat e vërtetuara, në shqyrtim gjyqësor, dëshmitë e dëshmitarëve të gjitha këtyre provave kjo gjykatë u kushtoi besim të plotë, e të cilat qojnë gjykatën në kolaudim se besueshmëria në to dhe shkalla e arsyesh mërisë së deklarimeve me rrethanat konkrete të rastit, nuk lënë vend për dyshim, prandaj gjykata gjënë se në veprimet e të akuzuarve vërtetohet se të njëjtit kanë kryer veprat penale ashtu siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata i pati parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për veprat penale për të cilën të akuzuarit janë shpallur fajtor, pastaj pati parasysh edhe qëllimin e dënimit dhe të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese nga neni 69 të KPRK-së, që ndikojnë në ashpërsimin ose zbutjen e dënimit

Gjykata duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për ashpërsimin e dënimit për të akuzuarin **S.K** ka gjetur, Shkallen e përgjegjësisë penale pasi që gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ishte i përgjegjshëm dhe përgjegjës për këtë veprë penale, dhe i njëjti veprën penale e ka kryer me dashje duke qenë i vetëdijshëm se me veprimet e ndërmarra ka dashur që shkaktohet pasoja, peshën e veprës penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të kryer, pasi kryerja e kësaj veprë penale është mjaftë e shprehur në vendin tone, shkalla e rrezikimit vlerësohet se rreziku është i lartë që i kanoset të mirës së mbrojtur, shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale, pasi që i njëjti me veprimet e tij thellësisht i ka kontribuar kryerjes së kësaj veprë penale dhe se veprën penale e ka konsideruar si të veten si dhe faktin se e i njëjti është recidivistë i veprave panel të natyrës se njëjtë kjo vërtetohet me aktgjykimin PKR.nr.300/2013 i plotfuqishëm me datë 30.12.2015, aktgjykim P.nr.55/2021 i plotfuqishëm me datë 05.08.2022.

Gjykata duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për zbutjen e dënimit, për të akuzuarin **S.K.** ka gjetur; Sjelljet e mira dhe korrekte të këtij të akuzuari, në raport me gjykatën dhe palët tjera.

Gjykata duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për ashpërsimin e dënimit për të akuzuarin **N.A** ka gjetur, Shkallen e përgjegjësisë penale pasi që gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ishte i përgjegjshëm dhe përgjegjës për këtë veprë penale, i aftë për t’i kuptuar sjelljet dhe veprimet e tij, peshën veprës penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të kryer, pasi kryerja e kësaj veprë penale është mjaftë e shprehur në vendin tone, shkalla e rrezikimit vlerësohet se rreziku është i lartë që i kanoset të mirës së mbrojtur, shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale, pasi që i njëjti me veprimet e tij thellësisht i ka kontribuar kryerjes së kësaj veprë penale dhe se veprën penale e ka konsideruar si të veten, faktin se i njëjti nuk është hera e parë që bien ndesh me ligjin ku sipas shënimeve të cilat i posedon kjo gjykatë ndaj tij janë zhvilluar procese tjera penale dhe për të cilin janë shqiptuar sanksion penal.

Gjykata duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për zbutjen e dënimit, për të akuzuarin **N.A** ka gjetur; Sjelljet e mira dhe korrekte të këtij të akuzuari, në raport me gjykatën dhe palët tjera, faktin se i njëjti në

fillim të shqyrtimit gjyqësor është deklaruar i fajshëm e ndjen vetën fajtor për veprat penale në të cilën ngarkohet sipas akuzës të PSRK-se, moshën e të akuzuarit pasi që njëjti është i moshës së re.

Gjykata duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për ashpërsimin e dënimit për të akuzuarin **P.C** ka gjetur, Shkallën e përgjegjësisë penale pasi që gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ishte i përgjegjshëm dhe përgjegjës për këtë veprë penale, dhe i njëjti veprën penale e ka kryer me dashje duke qenë i vetëdijshëm se me veprimet e ndërmarra ka dashur që shkaktohet pasoja, peshën veprës penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të kryer, pasi kryerja e kësaj vepre penale është mjaftë e shprehur në vendin tone, shkalla e rrezikimit vlerësohet se rreziku është i lartë që i kanoset të mirës së mbrojtur, shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale, pasi që i njëjti me veprimet e tij thellësisht i ka kontribuar kryerjes së kësaj vepre penale dhe se veprën penale e kanë konsideruar si të veten si dhe faktin se e i njëjti është përsëritës i veprave panel të natyrës se ngjashme.

Gjykata duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për zbutjen e dënimit, për të akuzuarin **P.C** ka gjetur; Sjelljet e mira dhe korrekte të këtij të akuzuari, në raport me gjykatën dhe palët tjera si dhe bashkëpunimi me gjykatën, mosha e të akuzuarit i njëjti është i moshës re.

Gjykata duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për ashpërsimin e dënimit për të akuzuarin **B.C** ka gjetur, Shkallën e përgjegjësisë penale pasi që gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ishte i përgjegjshëm dhe përgjegjës për këtë veprë penale, i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e tij, peshën veprës penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të kryer, pasi kryerja e kësaj vepre penale është mjaftë e shprehur në vendin tone, shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale, pasi që i njëjti me veprimet e tij thellësisht i ka kontribuar kryerjes së kësaj vepre penale dhe se veprën penale e kanë konsideruar si të veten, faktin se i njëjti nuk është hera e parë që bien ndesh me ligjin ku sipas shënimeve të cilat i posedon kjo gjykatë ndaj tij janë zhvilluar procese tjera penale dhe për të cilin janë shqiptuar sanksion penal, konkretisht i njëjti se e i njëjti është recidivist i veprave panel të natyrës se njëjtë kjo vërtetohet me aktgjykimi P.nr.1754/2019 i plotfuqishëm me datë 13.01.2021

Gjykata duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për zbutjen e dënimit, për të akuzuarin **B.C** ka gjetur; Sjelljet e mira dhe korrekte të këtij të akuzuari, në raport me gjykatën dhe palët tjera, faktin se i njëjti në fillim të shqyrtimit gjyqësor është deklaruar i fajshëm vetëm për posedim të substancave narkotike, mosha e të akuzuarit pasi që njëjti është i moshës së re.

Andaj, gjykata duke u bazuar në rrethanat e cekura si më lartë të akuzuarve iu shqiptojë dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin mbi konfiskimin gjykata e mori konform nenit 267 par. 5 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësorë, u mor konform nenit 449 par 1 dhe 2 nën par 2.1 dhe 2.6 si dhe nenit 452, të KPPK.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit 360, 361, 364 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**- Departamenti Special-**  
**PS.nr.26/2022, me datën 12.04.2023**

**Kryetari i trupit gjykues**  
Lutfi SHALA

Numri i lëndës: 2022:133112  
Datë: 03.07.2023  
Numri i dokumentit: 04444532

**UDHËZIM JURIDIK:** kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afatin prej **30 ditësh**, nga dita e marrjes së aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.